



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1337/2 prot.

Tiranë më 26.10.2018

**VENDIM**

Nr. 59, datë 26.10.2018

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, Qendra "Vizion i Gjellbër", me përfaqësuese znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1337 Prot., datë 03.09.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Bashkia Vlorë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 08.08.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm lidhur me:

1. *Një kopje të kontratave për dhënie në përdorim të plazheve publike, subjekteve që operojnë nga Shkolla e "Marinës" deri në Orikum.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1337 Prot., datë 03.09.2018 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 1337/1 Prot., datë 03.09.2018, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni.

Me shkresën nr. 1855/1 Prot., datë 07.09.2018 Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke refuzuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar me arsyetimin se përmbajtja e kontratave është konfidenciale.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, me shkresën nr. 1337/3 Prot., datë 17.09.2018, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 02.10.2018. Në seancë u paraqitën palët nëpërmjet perfaqësuesve të autorizuar prej tyre, respektivisht përfaqësuesja e autorizuar e palës ankuese me autorizimin datë 25.09.2018 dhe përfaqësuesja e autorizuar e Autoritetit Publik (autorizim nr. Ext Prot., datë 01.10.2018), Përgjegjësjë e Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave Publike pranë Bashkisë Vlorë.

Gjatë zhvillimit të seancës, përfaqësuesja e Autoritetit Publik sqaroi se, duke qenë voluminoz, informacioni i kërkuar do t'i vendoset në dispozicion kërkueses brenda datës 04.10.2018 kundrejt tarifave të përcaktuara.

Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 8014/1 Prot., datë 05.10.2018, Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje ankuesit duke i vënë në dispozicion kontratën tip, si dhe subjektet kontraktuese me të cilat Bashkia Vlorë ka lidhur kontratat për shfrytëzimin e hapësirës publike nga plazhi i Shkollës së Marinës deri në Orikum për sezonin turistik 15 Maj – 30 Shtator 2018, kjo në kundërshtim me objektin e kërkesës.

Në këto kushte, ankuesi ka vijuar ankimin me nr. 1337/6 Prot., datë 09.10.2018 pranë Komisionerit, i cili konstaton se, jashtë afatit të përcaktuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje pjesërisht kërkuarit duke mos përmbushur në tërësi objektin e kërkesës, pavarësisht thënieve gjatë seancës dëgjimore të përfaqësueses së këtij të fundit.

Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Bazuar në sa është parashtruar më sipër, vërehet se qëndrimi i Autoritetit Publik, pavarësisht përgjigjes së dhënë kërkuarit, në thelb përbën refuzim për dhënien e informacionit të kërkuar. Kërkuarit i është vendosur në dispozicion një informacion i përmbledhur dhe jo kopje e kontratave për dhënien në përdorim të plazheve publike,

subjekteve që operojnë nga Shkolla e "Marinës" deri në Orikum, siç është kërkuar në objektin e kërkesës.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Autoritetit Publik, pohoi se është ajo personi përgjegjës për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në cilësinë e Përgjegjëses së Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave Publike në Bashkinë Vlorë. Kjo, vërtetuar gjithashtu dhe nga praktika e administruar nga Zyra e Komisionerit, në të cilën rezultoi se kërkesa e Qendrës Vizion i Gjellbër është deleguar nga titullari i Autoritetit Publik për trajtim pranë kësaj drejtorie. Sa më sipër, për rastin konkret, Përgjegjësjë e Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave Publike në Bashkinë Vlorë ka marrë përsipër dhe ka vepruar në cilësinë e koordinatorit *ad hoc* për të drejtën e informimit. Pavarësisht angazhimit të marrë gjatë seancës dëgjimore për vënien në dispozicion të informacionit, angazhim kundrejt të cilit Komisioneri ra dakord për zgjatjen e afatit të vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar, Autoriteti Publik vijoi me qëndrimin refuzues, të cilin përfaqësuesja e tij e konfirmoi qoftë gjatë kontaktit verbal me Inspektorët e Zyrës së Komisionerit, qoftë me shkrim, ku në përgjigje të një përpjekje të mëtijshme të Komisionerit (e-mail datë 18.10.2018) për nxitjen e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit publik, përgjigja e marrë është një e-mail bosh me bashkëngjitur përgjigjen e paplotë të dhënë më parë.

Në bazë të nenit 18, pika 2, gërma a) e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.

Ligji për të Drejtën e Informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror që ushtron funksione publike. Njësitë e qeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", konkretisht neni Neni 15 "Transparenca e veprimtarisë së njësisë të vetëqeverisjes vendore", në të cilin parashikohet se: "1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.

2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike..."

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës Vizion i Gjellbër ndaj Bashkisë Vlorë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014

“Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, i ndryshuar,

#### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 1337 Prot., datë 03.09.2018 të Qendrës “Vizion i Gjellbër”, përfaqësuar nga Znj. , kundër Autoritetit Publik “Bashkia Vlorë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, dhe më konkretisht: *Një kopje të kontratave për dhënie në përdorim të plazheve publike, subjekteve që operojnë nga Shkolla e Marinës deri në Orikum*, brenda datës 02.11.2018.
3. Dënimin e Përgjegjëses së Drejtorisë së Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave Publike pranë Autoritetit Publik, Znj. , në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 4. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 26.10.2018.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

